



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KËLCYRË

Kelcyrë më, ____/____/2025

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROÇEDURËN E PROKURIMIT PROCEDURE E HAPUR -PUNË, PROKURIM ELEKTRONIK

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Këlcyra Historike dhe Natyrore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45112000-5 - Punime gjërmimi, 45210000-2 - Punime ndërtimi, 45454100-5 – Restaurime.
45452100-1 - Pastrim me presion i pjesëve të jashtme të ndërtesave

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **12,647,771,7** (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzet e shatate mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një pike shtate) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Këlcyrë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: **2022, 2023 dhe 2024**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore,

të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c (Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet, **për vitin 2025 për keestet e maturuara të vitit 2025.** (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 dhe 2025).

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për

të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm monument kulture në një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

Ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 190 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Kontratë Sipërmarrje

Situacionin përfundimtar

Akt i kolaudimit

Akt marrje në dorezim i perkohshëm / perhershëm

Formular vlerësimi leshuar nga Autoriteti kontraktor për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Faturat tatimore të deklaruara në organin tatimore ;

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Kontrate Sipërmarrje;

Situacion/faturë tatimore të deklaruara në organet tatimore ;

Dhe çdo lloj dokumenti tjetër që provon realizimin me sukses të punëve;

-Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve, Prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes se punimeve, të deklaruara në fazën e tenderimit.

-Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve.

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P - 1	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P - 3	A	Rikonstruks dhe miremb godinash civile dhe industrial, veshje fasada
N.P - 12	A	Punime te inxhinerise se mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S - 4	A	Punime te rifinitures te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me
---------	---	--

N.S- 14 A materiale druri, plastik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese
Impiante të brendshme elektrike,

Kjo licencë duhet të ketë afat vlefshmërie të paktën deri në përfundimin e punimeve të objektit që prokurohet.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar lidhja 2,3 dhe 4.

Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Konkretisht:

Llojet e licensave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në
---------------------	--	---	---	---

		kategorinë përkatëse		kategorinë përkatëse
NP - 1	Punime gjurmimi në tokë	<i>Sipas percaktimeve ne preventiv</i>	A	(0 – 20 milion lekë)
NP – 3	Rikonstruks dhe miremb godinash civile dhe industrial, veshje fasada	<i>Sipas percaktimeve ne preventiv</i>	A	(0 – 20 milion lekë)
NP – 12	Punime te inxhinierise se mjedisit	<i>Sipas percaktimeve ne preventiv</i>	A	(0 – 20 milion lekë)
NS - 4	Punime te rifinitures te muratures dhe lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese	<i>Sipas percaktimeve ne preventiv</i>	A	(0 – 20 milion lekë)
NS - 14	Impiante të brendshme elektrike	<i>Sipas percaktimeve ne preventiv</i>	A	(0 – 20 milion lekë)

2.3.2.1 Operatori ekonomik i licencuar, duhet të ketë një eksperiencë në fushën e restaurimit të monumenteve të arkitekturës, si subjekt i licencuar dhe të disponojë Licencën profesionale të operatorit ekonomik, si subjekt zbatimi për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës, të cilat i kanë dhënë të drejtën për të ushtruar këtë veprimtari profesionale, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

NE ZBATIM

- N-Z/A/1 Zbatim ne konservim dhe restaurim i rrenojave
- N-Z/A/5 Zbatim ne konservim dhe restaurim i arkitektures se tradites (vernakulare)
- N-Z/A/6 Zbatim ne konservim dhe restaurim i arkitektures se projektuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe VENDIM Nr. 792, datë 7.10.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË POSAÇME TË LICENCIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, NËNKATEGORIVE TË LICENCAVE, PROCEDURAVE PËR DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE REVOKIMIN, SI DHE KUOTIZACIONIT VJETOR TË LICENCAVE PËR NDËRHJRJET NË PASURITË KULTURORE MATERIALE”

Referuar zërave të preventivit, njësia e prokurimit gjykon se kërkesat e mësipërme janë në përputhje me objektin e kontratës, duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë në stafin tij teknik te perfshire ne licensen e shoqerise për të gjithë periudhën e zbatimit të objektit minimalisht:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi

1 (nje) Arkitekt

1 (nje) Restaurator i licensuar per Zbatim ne Konservim dhe restaurim sipas kategorive Z/A/1; Z/A/5; Z/A/6;

1 (nje) Inxhinier Elektrik.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontrata e punes
- Diploma
- CV

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri dhe formimi profesional i inxhinierëve që përbëjnë stafin kryesor teknik, është përcaktuar duke u nisur nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Kjo kërkesë është përcaktuar pas analizimit që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet edhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë. Duke parë dhe marrë në konsideratë kompleksitetin e punimeve që do të realizohen, referuar këtu projekt-preventivit të zbatimit, është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit të tij, inxhinierët e kërkuar në këtë pikë, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara

në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë NP-1, NP – 3, NS– 4, NP – 12.

- **Arkitekt** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë NP – 3, NS - 4
- **Restaurator** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë NP – 3, NS - 4
- **Inxhinier Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë NS – 14.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- *(Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për

mbarëvajtjen, ndërhyrjen, parandalimin dhe evitimin e situatave apo problematikave lidhur me rreziqet, sigurinë dhe shëndetin në punë, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë mbështetet edhe në dispozitat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, VKM nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Në dispozitat e akteve të sipërcituara, ndër të tjera parashikohet se: punëdhënësi merr masa për të ulur, sa më shumë të jetë e mundur, kërcënimet për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve e të personave të tjerë të pranishëm; organizon dhe siguron evakuimin e shpëtimit të punëmarrësit në rast ngjarjesh ose aksidentesh të papritura, që kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre; punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës; çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Pra, në dispozitat e akteve të mësipërme, përcaktohen kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik, emergjencë apo të papritura në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës, i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës, duke patur në fokus primar jetën dhe shëndetin e punonjësve të angazhuar me zbatimin e punimeve.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e shërbimit, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës Ndertues
- 1 (nje) punonjës Elektricitist
- 1 (nje) punonjës Hekurkthyes
- 1 (nje) punonjës Karpentier
- 2 (dy) punonjës Murator
- 1 (nje) punonjës Teknik Ndertimi
- 2 (dy) punonjës gurepunues
- 1 (nje) punonjës marangoz
- 1 (nje) punonjës betonues

Për punonjësit me profesionet si më sipër, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, Operatorët Ekonomikë duhet që: Gjate fazes së ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pika B. - Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit e mesiperm duhet të deklarojnë: emër/mbiemër, profilin e punës, subjektin leshues të

certifikates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes eshte privat), te cilat regjistrohen ne bazen e te dhenave te AKPA-se prane Ministrise se Financave (Institucioni pergjegjes per formimin profesional).

Diplomat/çertifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak jo vetëm për skualifikim.

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (certifikatë/deshmi), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqiperise.*”
- ****(Per tekniket e mesem duhet te paraqitet diploma ose deftesa e perfundimit te shkolles se mesme profesionale).***
- Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup certifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit vlerëson se kërkesa e mësipërme, është në përputhje me preventivin e punimeve, ku secili punëtor parashikoj të kryej zërat sipas fushës përkatëse të tij.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **20 (njezete) punonjës** të pasqyruar në listëpagesen e muajit të fundit. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve muajin e fundit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.4 dhe 2.3.5 duhet të plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.*

Konkretisht, në përcaktimin e numrit të punonjësve që duhet të ketë shoqëria ofertuese, janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë volumet, orët e punës, zërat, kategoritë dhe kompleksiteti i punimeve, kualifikimi i punonjësve (ku përfshihet stafit organizativ, administrativ, tekniko-inxhinierik dhe ai mbështetës), grafiku i punimeve dhe shpërndarja e kantierit etj. Vendosja e këtij kriteri është teknikisht i argumentuar, pasi i përgjigjet përmasave të kontratës që prokurohet si për nga fondi limit, kohështirja, por edhe për nga natyra e punimeve duke marrë në analizë manualin teknik të punimeve të ndërtimit në fuqi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje minimalisht muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmërinë e nevojshme për autoritetin kontraktor lidhur me përmbushjen e kontratës nga OE. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të Operatorit Ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është detyrim i punëdhënësit sipas parashikimeve të legjislacionit të fushës dhe Kodit të Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarëve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat e kualifikimit, përveç besueshmërisë së Operatorëve Ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, dhe njëkohësisht është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës së punonjësve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve, mbështetur në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

NR	NR AN	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ore/njesi puntori	Shuma ore puntori	ore/njesi makineri	Shuma ore makineri
		1. PUNIME DHEU						
1	2.1	Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III >	m3	140.0	3.7	518	0	0
2	2.1	Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III >	m3	265.0	3.7	980.5	0	0
3	2.1	Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III >	m3	45.0	3.7	166.5	0	0
		Shuma 1:				1665		0
		2. PUNIME GERMIMI						
4	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km >	m3	140.0	0	0	0	0
5	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km >	m3	265.0	0	0	0	0
6	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km >	m3	45.0	0	0	0	0
		Shuma 2:				0		0
		3. PUNIME SHPYLLEZIMI						
7	3.1	Skarifikim bari me lopate >	m2	400.0	0.06	24	0	0
8	3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm >	m2	400.0	0.08	32	0	0
9	3.1	Skarifikim bari me lopate >	m2	660.0	0.06	39.6	0	0
10	3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm >	m2	650.0	0.08	52	0	0
11	3.1	Skarifikim bari me lopate >	m2	180.0	0.06	10.8	0	0
12	3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm >	m2	180.0	0.08	14.4	0	0
13	3.1	Skarifikim bari me lopate >	m2	541.0	0.06	32.46	0	0

14	3.2	Prerje bime te vogla $\varnothing \sim 10\text{cm} >$	m2	541.0	0.08	43.28	0	0
		Shuma 3:				248.54		0
		4. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME						
15	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve >	m3	140.0	0.04	5.6	0.04	5.6
		Shuma 4:				5.6		5.6
		5. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE						
16	2.602	Pedane druri (binare+derrase) >	m2	378.0	1.6	604.8	0	0
		Shuma 5:				604.8		0
		6. PUNIME SHTRESASH						
17	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri >	m2	620.0	0.28	173.6	0.265	164.3
18	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri >	m2	180.0	0.28	50.4	0.265	47.7
		Shuma 6:				224		212
		7. PUNIME TE NDRYSHME						
19	3.616/a	F.V. Bordura betoni 15x25cm >	m	120.0	0.8	96	0	0
		Shuma 7:				96		
		8. PUNIME SHTRESASH 2						
20	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 >	m3	7.0	8.6	60.2	0.73	5.11
21	2.275	Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >	m3	19.0	8.6	163.4	0.73	13.87
		Shuma 8:				223.6		18.98
		9. PUNIME BETONI E BETONARMEJE						
22	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 >	m3	28.0	12.8	358.4	2.29	64.12

		Shuma 9:				358.4		64.12
		10. PUNIME HEKUR BETONI						
23	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm >	ton	0.9	60	54	0.63	0.567
24	2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm >	ton	1.45	42	60.9	0.63	0.9135
		Shuma 10:				114.9		1.4805
		11. PUNIME MURATURE GURI						
25	2.54/2	Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç çimento M 25 >	m3	48.0	16.3	782.4	1.04	49.92
		Shuma 11:				782.4		49.92
		12. ANALIZA JASHTE LISTE						
26	An	Korimano metalike, me mbeshtetese metalike lyer me boje te zeze >	ml	269.0	0.9	242.1	0	0
27	An	Shtrese me pllaka guri 8cm >	m2	162.0	2.46	398.52	0	0
28	An	Shtrese druri 2cm fiksuar ne siperfaqe betoni >	m2	50.0	0.4	20	0	0
29	An	Pastrim i fasadës nga pluhurat dhe depozitimet siperfaqesore me ujë, me pompë me presion, (idropulitrice). >	m2	1800.0	0.5	900	0.3	540
30	An	Ndricues tipi prozhektor >	copë	80.0	1.2	96	0	0
31	An	Tuba fleksibël korrugat Ø90 mm per linja te ndricimit rrugor >	ml	270.0	0.25	67.5	0	0
32	An	Kabell me izolacion FROR 3x1.5mm2 Cu Tu 0.6/1kV >	ml	700.0	0.2	140	0	0
33	An	Pusetë plastike [30x30x30]cm, kapak të fortë RIC 1084+1086 >	copë	80.0	1.9	152	0	0

34	An	Panel ndriçimit, I perbere nga rele kohe, rele krespulare, kontaktor 4p, automat magnetotermik dhe diferenciale, llampe preyence tensioni, box >	copë	1.0	6	6	0	0
		Shuma 12:				2022.12		540
		SHUMA TOTALE				6249.36		827.98

3 muaj x 22 ditë pune/ muaj = 66 ditë pune

66 ditë pune x 8 orë pune/ dita = 528 orë pune

6249.36 orë totale punëtor / 528 orë pune = 11.83 ≈ 12 punëtor

827.98 orë totale makineri / 528 orë pune = 1.56 ≈ 2 manovrator/shofer

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se ka të punësuar muajin e fundit dhe figuron në listëpagesat e subjektit, punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Shofer –1 punonjes
- Eskavatorist/Manovrator/automakinist – 1 punonjes

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastruktursë dhe Energjitikës.

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- **Eskavatorist/Manovrator** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve të rënda që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 1 manovratorë.
- **Shoferët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve (kamionave) që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit,

afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 1 shoferë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për stafin mbështetës të kërkuar në objekt, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Nëpërmjet këtij stafi, synohet realizimi i objektit të kontratës brenda afatit, normave dhe me cilësi sipas standardeve në fuqi. Stafi mbështetës është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi/qira/kontrate furnizimi:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
1	Ekskavator me Goma	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Copë	2	Ne pronësi ose me qera
3	Kamioncine deri 3.5 ton	Copë	2	Ne pronësi ose me qera
4	Kamion me Vinc	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
5	Fadrome me goma	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
6	Gjenerator	Cope	2	Ne pronësi ose me qera
7	Depozite uji deri në 5000 litra	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
8	Kamion vetshakkrues 3.5 - 12 ton	cope	1	Ne pronësi ose me qera
9	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
10	Pompe uji	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
11	Kompresor ajri sebashku me pajisjen pastruese	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
12	Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secili	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
13	Kokore	Copë	20	Ne pronësi ose me qera
14	Jelek	Copë	20	Ne pronësi ose me qera
15	Karroca dore	Copë	3	Ne pronësi ose me qera
16	Vibrator betoni	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
17	Tabela paralajmeruese	Copë	3	Ne pronësi ose me qera

a.Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (Çertifikatë Pronësie e mjetit nëse nuk është pajisur me lejen e re të

qarkullimit), leje qarkullimi, çertifikaten e kontrollit Teknik (te vlefshme), siguracionin e mjetit (te vlefshme), çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b.Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (Çertifikatë Pronësie e mjetit nëse nuk është pajisur me lejen e re të qarkullimit), leje qarkullimi, çertifikaten e kontrollit Teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (te vlefshme), çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për të tretë (e vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

c.Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjete dhe targa e tij.

d.Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese.

e.Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

f.Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera,(Deklarate nga Administratori i Shoqerise Ofertuese).

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.7 duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë minimalisht mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e punimeve, me qëllim për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i mjeteve, makinerive e pajisjeve të cilat duhet të disponohen nga OE në një tërësi prej formave të kërkuara, janë vlerësuar si të nevojshme, në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve objekt kontrate. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike sa i përket disponimit të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, e për këtë qëllim janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqiten si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave të përcaktuara. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në

përcaktimin e numrit të punonjësve dhe mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e punimeve objekt kontrate, janë marrë në konsideratë përcaktimet e bëra në manualin e çmimeve në fuqi, si dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- **Çertifikatën për sistemimin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme)** ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

- **Çertifikatën për sistemimin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 (e vlefshme)** ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

- **Çertifikatën për sistemimin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2023 (e vlefshme)** ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e

punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

Argumentimi: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.* Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.10 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Per disa ndryshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”). Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin perkates .

Argumentimi: *Duke qenë se në preventiv kemi kryerjen e punimeve të ndryshme dhe transportin e tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë*

26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jetë kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë gjatë fazës së vlerësimit të ofertave të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar apo dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në çdo rast, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkojë kopjen origjinale të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik ofertues. Rastet e mos-dorëzimit të dokumentacionit origjinal brenda afatit të kërkuar nga AK, konsiderohen si kusht për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si

dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Bazuar në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga njësia e prokurimit.

- U diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe u bë miratimi i dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT